

KOMUNA - MITROVICË



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica



KONTRATË – FURNIZIM DHE PUNË

TITULLI I KONTRATËS

Sanimi i dëmeve të shkaktuara nga era në Kulmin e SHFMU E.Peci –Rahovë.

Nr ¹ i prokurimit	642-19-1452-5-3-6/B05
Nr i brendshëm	642/19/009/536

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

KONTRATË: Sanimi i dëmeve të shkaktuara nga era në Kulmin e SHFMU E.Peci –Rahovë.
Nr i prok: 642/19/1452/536 dhe **Nr I brend:** 642/19/009/536–PUNË.

PJESA B: KONTRATA

KOMUNA- MITROVICË, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;

dhe

N.N.P."NDERTIMTARI-MAXHUNAJ", Maxhunaj Vushtrri, 420000, **MAXHUNAJ** (në vazhdim "Kontraktori"), me nr Biznesi:800255939 dhe nr Fiskal: 600188545 nr i tel:049/406845 në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizim me material dhe kryerje të punëve [Sanimi i dëmeve të shkaktuara nga era në Kulmin e SHFMU E.Peci –Rahovë.

] - si në vijim:

Neni 1 Lënda: Sanimi i dëmeve të shkaktuara nga era në Kulmin e SHFMU E.Peci –Rahovë.

me numër identifikues: Nr i Prokurimit: 642-19-14552-5-3-6/B05

Nr i brendshëm: 642/19/009/536

1.1 Lënda e kontratës do të jetë [furnizimi dhe dërgesa], [kryerja e punëve], nga punëkryesi në vijim:

1.1 Lënda e kontratës do të jetë Sanimi i dëmeve të shkaktuara nga era në Kulmin e SHFMU E.Peci –Rahovë.

1.2 Furnizimi me material dhe kryerja e punëve sipas paramasës në përshkrimin e qmimeve

1.3 Plani Dinamik për kryerje të punëve është 20 ditë pune.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me 26/04/2019 dhe përfundon me 25/05/2019

1.5 Afati kohor i performancës nuk mund të jetë më shumë se 2 ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.6 Vendi i [kryerjes së punëve] do të jetë [SHFMU Elmaz PEÇI-RAHOVË].

1.7 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP² (Detyra e Dërguar e Paguar).

² DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

KONTRATË: Sanimi i dëmeve të shkaktuara nga era në Kulmin e SHFMU E.Peci –Rahovë.
Nr i prok: 642/19/1452/536 dhe Nr i brend: 642/19/009/536–PUNË.

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Cmimi total i kontratës do të jetë: **[4.696,00 €]**; [katër mijë e gjashtëqindë e nëndhjet Euro 00/100].

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të punëve sipas situacioneve të punëve të kryera apo punëve të kryera në total pas pranimit nga komisioni i pranimit dhe raportit të nënshkruar nga ky komision.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të punëve të kryera]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti *[punëve]* duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë.

KONTRATË: Sanimi i dëmeve të shkaktuara nga era në Kulmin e SHFMU E.Peci –Rahovë.
Nr i prok: 642/19/1452/536 dhe Nr I brend: 642/19/009/536–PUNË.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për **12 muaj**, pas pranimit të **[punëve]**.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *[te kryej ndonjë ose te gjitha punët]* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me **0,25% në ditë të vlerës së [furnizimeve] [punëve] [shërbimeve]** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej **10 % të vlerës totale të kontratës**.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, punëve apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer

KONTRATË: Sanimi i dëmeve të shkaktuara nga era në Kulmin e SHFMU E.Peci –Rahovë.

Nr i prok: 642/19/1452/536 dheNr I brend: 642/19/009/536–PUNË.

një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.



13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [specifiko gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip] [Serbisht] [Anglisht]³ në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues:Komuna-Mitrovicë	
Emri:	Haxhimet FERATI
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	26/04/2019
Vula:	

Për Kontraktorin: N.N.P."NDERTIMTARI-MAXHUNAJ", Maxhunaj	
Emri:	Sali MAXHUNI
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	26/04/2019
Vula:	

³ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

**KONTRATË: Sanimi i dëmeve të shkaktuara nga era në Kulmin e SHFMU E.Peci –Rahovë.
Nr i prok: 642/19/1452/536 dheNr I brend: 642/19/009/536–PUNË.**

PJESA V E KONTRATËS: IDENTIFIKIMI FINANCIAR

MBAJTËSI I LLOGARISË	
Emri	N.N.P."NDERTIMTARI-MAXHUNAJ", Maxhunaj
Adresa	Vushtrri,Maxhunaj
Qyteti	Vushtrri
Kodi Postar	42000
Kontakti	Sali MAXHUNI
Telefoni	049/406845
Fax	
E-mail	ndertimtarimaxhunaj@hotmail.com
Numri i TVSH	330036003

BANKA	
Emri	
Adresa	
Qyteti	
Kodi Postar	
Shteti	
Llogaria Bankare	
IBAN (opcionale)	
BIC (Opcionale)	

SHËNIME:

<u>VULA E BANKËS + NËNSHKRIMI I PËRFAQËSUESIT TË BANKËS (Të dyja të obligueshme)</u>

<u>DATA + NËNSHKRIMI I MBAJTËSIT TË LLOGARISË: (e obligueshme)</u>

KONTRATË: Sanimi i dëmeve të shkaktuara nga era në Kulmin e SHFMU E.Peci –Rahovë.
Nr i prok: 642/19/1452/536 dheNr I brend: 642/19/009/536–PUNË.